




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-12830/23 datë:23.05.2023



Npi – 01/207 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenit 13.1 pika (a) dhe neni 13.3 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë 01Nr.06/570-60 të datës, 30.03.2012, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR NDARJEN
E BURSIVE PËR STUDENTË PËR VITIN 2023/2024**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 31.05.2023, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2023/2024, sa është paraparë të zgjidhen sipas rregullores, si vijon:

II

Dy anëtarë të Komisionit nga Kuvendi sipas nenit 13.1 pika (a) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Nr.01/06/570-60 dt. 30.03.2012.

1. z.Muhamet Ademaj.....(Përfaqësues nga pozita)
2. znj.Albana Podvorica.....(Përfaqësuese nga opozita)

III

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, me numër 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/474 të datës 02.06.2023 si vijon:

3. z.Besnik Shala (Zyrtar për Arsim)
4. znj.Tringa Rushiti.....(Zyrtare për Arsim)

IV

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, e dërgojnë përfaqësuesit e Studentëve ose shoqërisë civile:

5. z.Durim Ademaj.....(Përfaqësues i Studentëve)

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Arsim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi